



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:247391  
Datë: 23.11.2022  
Numri i dokumentit: 03679971

**C.nr.1061/2021**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit J. Z. nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj i autorizuar avokati M. B. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të pagave në emër të daljes në pension dhe shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 2,085.18 Euro, pas dhënies së përgjigjes në padi, më datë 23.11.2022, mori këtë:**

### **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadija e paditësit **J. Z.** nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të pensionimit, t'i paguaj tri paga mujore në lartësi të pagës mesatare për tre muajt e fundit, në shumë prej me nga 1,390.68 Euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për katër dhjetë e një (41) vite të përvojës së punës ti paguaj shumën prej 694,50 €, (150 % të pagës bazë prej 463,56 €), apo gjithsejtë shumën prej **2,085.18 Euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 03.11.2021, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

**II. DETYROHET** e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 177,00 Euro me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi J. Z., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar kësaj gjykate i ka ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të pagave në emër të daljes në pension dhe shpërblimit jubilar.

Në padi, paditësit kanë theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në SHFM “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit, sipas kontratës për punë si mësimdhënës nga data 28.10.2015. pasi që paditësi i ka plotësuar kushtet për pensionimin, me vendimin e DKA-së, Komuna e Rahovecit, si dhe ka përvojë pune prej 41 vite 10 muaj e 16 ditë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. M. B., me parashtresë të datës 18.11.2022, ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë, duke shtuar se njëherit bëjë precizimin e petitimit të kërkesëpadiisë që ka të bëjë me shpërblimin jubilar ashtu që palës paditëse në emër të shpërblimit

jubilar i takojnë pagat, përkatësisht 150 % e një page bazë për shpërblim jubilar, pasi që i njeëti posedon stazhin e punës, mbi 41 vite, si dhe në emër të daljes në pension tri paga mesatare sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit. Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe prova të dorëzuara i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e precizuar të aprovohet në tërësi si e bazuar, si shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar sipas tarifës së OAK-së.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt. 03.02.2022, ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se konsideron se padia si e tillë është e pa themeltë dhe e pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Padia e paditësit nuk është bazuar në asnjë provë materiale me të cilën do të argumentohet kërkesëpadia. Gjithashtu, padia e paditësit nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ndërsa baza në të cilën është thirrur pala paditëse, rezulton se kërkesa për kompensim është parashkruar në tërësi. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 03.11.2021, me të cilën ka kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar dhe të Kontratës së Përgjithshme Kolektive e cila kontratë ka qenë në fuqi deri më 31.12.2017, respektivisht paditësi sipas deklaramentit në padi është pensionuar më 16.06.2021, në këtë mënyrë konsideron se kërkesëpadia është e parashkruar në tërësi, ngase nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar dhe të Kontratës së Përgjithshme Kolektive e deri në parashtrimin e padisë në gjykatë më 03.11.2021, kanë kaluar më shumë se tri vite. Paditësi, përveç padisë nuk ka bashkëngjitur asnjë provë materiale në të cilat thirret. E paditura ka pranuar vetëm padinë si të tillë, ndërsa padia është kontradiktore në përmbajtjen e saj sa i përket të dhënave për kohën e pensionimit të paditësit. Sipas listës së pagave të punëdhënësit, vërtetohet fakti i pa kontestueshëm se paditësi i ka gjithsej 42 vitet e përvojës së punës në muajin maj 2021 (një muaj para pensionimit), në këtë mënyrë konstatohet se i njëjti ka arritur 40 vitet jubilarë në vitin 2019. Në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësit nuk ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë të rregullt administrative pranë të paditurës. Respektivisht, paditësit nuk ka argumentuar me asnjë provë se ka parashtruar kërkesë apo ankesë drejtuar punëdhënësit. Të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore. Padia është e pathemeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit - DKA. Në kuptim të nenit 99, në lidhje me dispozitat e neneve 395.1, 395.2, 396.1, 399.1 dhe 399.2 të LPK, gjykata pas shqyrtimit të çështjes dhe administrimit të provave, mbrojtjen e të paditurës ta aprovoj si të bazuar dhe të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Paditësi padisë ia ka bashkëngjitur provat materiale si në vijim: kontratën e punës nr. i protokollit 158/05, prej datës 28.10.2015, ka bërë shikimin në vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës nr. i prot. 821, prej datës 11.06.2021, si dhe ka bërë shikimin në vërtetimin nr. i protokollit 2010/05, prej datës 16.06.2021.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar se paditësi kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit J. Z. nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të pensionimit, t'i paguaj tri paga mujore në lartësi të pagës mesatare për tre muajt e fundit, në shumë prej me nga 1,390.68 Euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për katër dhjetë e një (41) vite të përvojës së punës ti paguaj shumë prej 694,50 €, (150 % të pagës bazë prej 463,56 €), apo gjithsejtë shumë prej 2,085.18 Euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1

dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (08.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Sipas dispozitës së nenit 35.8 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: ***Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50 % të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse. 8.6 Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti". 9. Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.***

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t'ia kompensojë edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 177,00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 156,00 €, dhe në emër të taksës për padi 21,00 €, bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELROE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC,  
C.nr.1061/2021, më 23.11.2022**

B. Profesional  
Armond Qmega

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.